

VENDIM
Nr. 832, datë 24.12.2021

**PËR DEKLARIMIN PASURI KULTURORE “QENDËR HISTORIKE” TË
FSHATIT BËNJË, PËRCAKTIMIN E ZONËS MBROJTËSE TË SAJ DHE
MIRATIMIN E PLANIT PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN E ADMINISTRIMIN E
TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, pika 3, shkronjat “a” e “ç”, dhe 96, pika 1, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deklarimin pasuri kulturore “Qendër historike” të fshatit Bënjë, sipas koordinatave dhe hartës së zonifikimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Përcaktimin e zonës mbrojtëse të “Qendrës historike” të fshatit Bënjë, sipas koordinatave dhe hartës së zonimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 3. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e këtyre zonave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 4. Vendimi nr. 776, datë 2.11.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e qendrës historike të fshatit Bënjë dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth”, shfuqizohet.
 5. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor të publikojë hartën e “Qendrës historike” të fshatit Bënjë dhe të zonës mbrojtëse të saj në Gjeoportalin Kombëtar.
 6. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Përmet për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**PLANI PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E “QENDRËS
HISTORIKE” TË FSHATIT BËNJË DHE TË ZONËS MBROJTËSE TË SAJ**

Neni 1
Qëllimi dhe objektivat

Ky plan ka për qëllim miratimin e rregullave, të procedurave, të autoriteteve shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e “qendrës historike” të fshatit Bënjë dhe zonës mbrojtëse përreth saj.

Neni 2
Objekti

Objekti kryesor të këtij plani janë:

a) ruajtja dhe mbrojtja e vlerave të trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkitektonike dhe të peizazhit të “qendrës historike” të fshatit Bënjë dhe zonës mbrojtëse të saj, sipas hartës së zonifikimit bashkëlidhur;

b) administrimi i “qendrës historike” të fshatit Bënjë dhe zonës mbrojtëse të saj;

c) mënyrat e bashkëpunimit të institucioneve të ngarkuara për ruajtjen dhe miradministrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të fshatit Bënjë, me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Neni 3

Hapësira urbane në mbrojtje

1. Hapësira në mbrojtje e fshatit Bënjë përbëhet nga:

a) “qendra historike”;

b) zona mbrojtëse.

2. Brenda zonave të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, përfshihen zona e banuar e fshatit, pasuri kulturore të paluajtshme, zona të gjelbra, sheshe dhe objekte pa status, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

3. Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Përmet merr parasysh kufijtë e zonifikimit të “qendrës historike”, të zonës mbrojtëse të saj, si dhe rregullat për ruajtjen, mbrojtjen e administrimin e tyre.

4. Organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionet shtetërore të specializuara, sigurojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e “qendrës historike”, të zonës mbrojtëse të saj dhe të monumenteve të kulturës, të ngritura në hapësirat e juridiksionit të tyre.

Neni 4

“Qendra historike” dhe kufijtë e saj

1. “Qendra historike” e fshatit Bënjë është hapësira me vlera të rëndësishme të trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkitektonike dhe të peizazhit, në të cilat dokumentohen rruga e zhvillimit historik të fshatit drejt krijimit të një qendre të banuar dhe tiparet urbanistiko-arkitektonike, që u formuan gjatë historisë së tij. Pjesa dërrmuese e fshatit ruan rrjetin rrugor karakteristik dhe ndërtime të vjetra, me vlera arkitektonike e konstruktive. Këto ndërtime janë të lidhura me mjedisin tradicional, i cili është pjesë e “qendrës historike”.

2. Në “qendrën historike” ndodhen pasuri kulturore të paluajtshme si monumente kulture të kategorisë I, si kisha e Shën Mërisë, të kategorisë II dhe objekte pa status.

3. Kufijtë e “qendrës historike” paraqiten në hartën e zonifikimit, e cila është pjesë përbërëse e këtij plani.

4. Koordinatat në sistemin referues gjeodezik zyrtar – KRGJSH, të “qendrës historike” paraqiten në aneksin 1, që është pjesë përbërëse e këtij plani.

Neni 5

Zona mbrojtëse dhe kufijtë e saj

1. Zona mbrojtëse përreth “qendrës historike” mbron e plotëson vlerat e trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkitektonike dhe të peizazhit.

2. Ajo shtrihet përreth “qendrës historike” dhe krijon një kalim të butë drejt pjesës tjetër të fshatit. Në pjesën juglindore, ajo shtrihet duke përfshirë edhe një pjesë të rrugës hyrëse për në fshat, e cila, nisur edhe nga konfiguracioni i terrenit, shërben për të mbrojtur më mirë peizazhin arkitektonik e kulturor të qendrës historike të fshatit Bënjë.

3. Kufijtë e zonës mbrojtëse paraqiten në hartën e zonifikimit, e cila është pjesë përbërëse e këtij plani.

4. Koordinatat në sistemin referues gjeodezik zyrtar – KRGJSH, të zonës mbrojtëse paraqiten në aneksin 2, pjesë përbërëse e këtij plani.

Neni 6

Ndërhryrjet e lejuara në qendrën historike

1. Ndërhryrjet në “qendrën historike” kanë si qëllim ruajtjen e mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkitektonike dhe të peizazhit të fshatit Bënjë.

2. Brenda kësaj zone lejohen këto ndërhryrje:

- a) Ndërhryrje sistematike restauruese, konservuese dhe të mirëmbajtjes;
- b) Ndërhryrje restauruese, që synojnë ruajtjen e hapësirave urbanistike-arkitekto-re, të rrjetit rrugor tradicional në kompozim dhe teknikë, duke përfshirë të gjitha kanalizimet e vjetra të zbuluara ose që do të zbulohen, si dhe duke ruajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit të hapësirave dhe të shesheve publike;
- c) Rikonstruksione dhe rindërtime të ndërtesave ekzistuese mbi strukturat ekzistuese, sipas formulimit kompozicional dhe arkitektonik origjinal, duke u bazuar në materiale arkivore e fotografike;
- ç) Rehabilitimi i hapësirave, të cilat ndikojnë në vlerat e unitetit kompozicional të ansamblit, duke u bazuar në format dhe në teknikat tradicionale;
- d) vendosja e strukturave të përkohshme, fiksimi i flamujve, vendosja e materialeve informuese dhe reklamuese, sipas nenit 101, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Neni 7

Ndërhryrjet e lejuara në monumentet e kulturës

1. Ndërhryrjet në monumentet e kulturës dhe në zonën mbrojtëse të tyre, të cilat ndodhen në “qendrën historike” dhe zonën mbrojtëse, kanë për qëllim ruajtjen e mbrojtjen e vlerave për të cilën janë shpallur pasuri kulturore.

2. Brenda kësaj zone lejohen:

- a) ndërhryrje sistematike restauruese, konservuese dhe të mirëmbajtjes;
- b) rrijetëzime, me kusht që projekti i rrijetëzimit të mos dëmtojë vlerën e pasurisë kulturore, sipas ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;
- c) vendosja e strukturave të përkohshme, fiksimi i flamujve, vendosja e materialeve informuese dhe reklamuese, sipas nenit 101, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Neni 8

Ndërhryrjet e lejuara në zonën mbrojtëse të “qendrës historike”

Ndërhryrjet e lejuara brenda zonës mbrojtëse janë:

- a) restaurime, rikonstruksione dhe rindërtime të ndërtesave ekzistuese;
- b) rikonstruksione dhe ndërtime të reja të rrjetit rrugor, të shesheve dhe të linjave të infrastrukturës mbi- dhe nëntokësore;
- c) ndërtime të reja, shtesa dhe përshtatje në sheshe të lira, në harmoni me karakteristikat e “qendrës historike”.

Neni 9

Ndërhryrjet e ndaluara në tërësinë e “qendrës historike” dhe zonës mbrojtëse të saj

1. Në hapësirën e “qendrës historike” dhe zonës mbrojtëse të saj nuk lejohen ndërtimet e reja që prekin monumentet e kulturës dhe zonat mbrojtëse të tyre.

2. Në zonën mbrojtëse të “qendrës historike” nuk lejohen ndërtimet me karakter industrial, me përjashtim të punishteve të artizanatit.

Kriteret e projektimit për rikonstruksione, ndërhyrjet e lejuara në “qendrën historike”, monumentet e kulturës dhe zonës mbrojtëse të tyre

1. Projektet për konservimin, restaurimin e mirëmbajtjen në “qendrën historike” dhe monumentet e kulturës hartohen në varësi të vlerave historike-kulturore të objektit apo monumentit për të cilët janë shpallur pasuri kulturore, si dhe në kriteret për konservim e restaurim, bazuar në kartat ndërkombëtare për restaurim.

2. Projektet për rikonstruksionin/rindërtimin e objekteve ekzistuese brenda “qendrës historike” hartohen bazuar në studimet urbanistike dhe arkitektonike:

- a) duke ruajtur karakteristikat tradicionale të banesave të zonës;
- b) duke respektuar raportet urbanistike e vëllimore, trajtimin arkitekturor dhe elementet arkitektonike;
- c) duke ruajtur sa më shumë trajtimin origjinal të pamjeve të jashtme, duke respektuar volumin ekzistues, ndërsa brendësia e tyre mund të ndryshojë duke respektuar elemente të veçanta me vlerë për trashëgiminë kulturore;

ç) duke ruajtur, sa të jetë e mundur, karakteristikat origjinale të dukshme, të jashtme dhe të brendshme, tipologjinë, trajtimin arkitektonik dhe teknikën tradicionale;

d) bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik dhe grafik, nëse disponohet.

3. Projektet për rikonstruksionin/rindërtimin e objekteve ekzistuese brenda zonës mbrojtëse hartohen bazuar në planin e detajuar vendor të Bashkisë Përmet apo të studimeve urbanistike e arkitektonike:

- a) duke ruajtur karakteristikat tradicionale të banesave në këtë zonë;
- b) duke ruajtur sa më shumë trajtimin origjinal të pamjeve të jashtme, duke respektuar volumin ekzistues, ndërsa brendësia e tyre mund të ndryshojë duke respektuar elemente të veçanta me vlerë për trashëgiminë kulturore.

4. Projektet për ndërtimet të reja, shtesat dhe përshtatjet në sheshe të lira brenda zonës mbrojtëse hartohen vetëm në ato terriore, në të cilat leja e ndërtimit nuk bie ndesh me ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, këtë plan, ligjin “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe rregulla të tjera në fuqi:

a) duke ruajtur karakteristikat tradicionale të banesave në zonën e mbrojtur të “qendrës historike”;

b) duke respektuar përpjesëtimet urbanistike e vëllimore të treguesve zhvillimorë, parashikuar në planin e përgjithshëm vendor të Bashkisë Përmet;

c) duke respektuar tipologjinë e ndërtimeve në atë zonë lidhur me kompozimin planimetrik dhe planvendosjen në sheshin e ndërtimit;

ç) duke ruajtur kufizimin që lartësia e ndërtimeve të reja apo rikonstruksioneve dhe përshtatjeve nuk duhet të kalojë lartësinë e 3 (tre) kateve;

d) duke ruajtur origjinalitetin e ndërtimit të çatave të ndërtimeve të reja, në rastet e mbulesave me çati, në harmoni me peizazhin kulturor të zonës mbrojtëse;

dh) duke përcaktuar materialin, madhësinë, ngjyrën e dyerve dhe të dritareve, si dhe ngjyrën e fasadës së banesës/objektit, në harmoni me peizazhin kulturor të zonës mbrojtëse.

5. Projektet për rikonstruksionin dhe ndërtimet e reja të rrjetit rrugor, të shesheve dhe linjave të infrastrukturës mbi- dhe nëntokësore hartohen:

a) bazuar në parashikimet e planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Përmet;

b) duke mos cenuar vlerat e objekteve ekzistuese;

c) duke mos krijuar kontrast me kompozimin urban dhe arkitektonik.

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në “qendrën historike”, monumentet e kulturës të veçanta dhe zonës mbrojtëse të saj

1. Studimet për vlerësimin e ndërhyrjeve konservuese dhe restauruese në “qendrën historike” dhe zonën mbrojtëse të saj, duke përfshirë banesat, fasadat e tyre, muret rrethuese, kalldrëmet tradicionale dhe elemente të tjera urbanistike-arkitektonike dhe monumenteve të kulturës hartohen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK) Gjirokastër ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë të licencuar në fushën e restaurimit dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM). Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

2. Projektet për konservimin, restaurimin dhe mirëmbajtjen në “qendrën historike” dhe monumentet e kulturës hartohen nga IKTK-ja, DRTK Gjirokastër ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë të licencuar për projektim në fushën e restaurimit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK Gjirokastër ose subjekte të licencuara për zbatim në fushën e restaurimit. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

3. Projektet për rikonstruksionin/rindërtimin e objekteve ekzistuese, rehabilitimin e hapësirave në “qendrën historike” hartohen nga IKTK-ja, DRTK Gjirokastër ose nga subjekte të licencuara, sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin e territorit. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit kryhet nga subjekte të licencuara për zbatim në fushën e restaurimit. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

4. Projektet për rikonstruksionin/rindërtimin e objekteve ekzistuese dhe ndërtimet të reja në zonën mbrojtëse hartohen nga IKTK-ja, DRTK Gjirokastër ose nga persona të licencuar për këtë kategori projektesh. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit kryhet nga subjekte të licencuara në këtë kategori. Mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhen nga subjekte të licencuara në këtë kategori dhe monitorohet nga DRTK Gjirokastër.

5. Projektet për rikonstruksionin e rrjetit rrugor dhe të shesheve në “qendrën historike” hartohen nga IKTK-ja, DRTK Gjirokastër ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë të licencuar për projektim në fushën e restaurimit dhe projektet për realizimin e linjave të infrastrukturës mbi-dhe nëntokësore hartohen nga persona të licencuar sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK Gjirokastër ose subjekte të licencuara për zbatim në fushën e restaurimit dhe sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve kryhet sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

6. Projektet për rikonstruksionin dhe ndërtimet e reja të rrjetit rrugor, shesheve dhe linjave të infrastrukturës mbi- dhe nëntokësore në zonën mbrojtëse hartohen nga persona të licencuar sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit, mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhen sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. DRTK Gjirokastër monitoron procesin e zbatimit të punimeve.

7. Projektet për vendosjen e strukturave të përkohshme, fiksimit të flamujve, vendosjen e materialeve informuese dhe reklamuese në “qendrën historike” dhe monumentet e kulturës shqyrtohen nga IKTK-ja, DRTK Gjirokastër e miratohen me urdhrin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Në rastet kur projekti parashikon ndërhyrje në pasuritë kulturore, hartimi bëhet nga persona fizikë apo juridikë të licencuar për projektim në fushën e restaurimit. Projektet


shqyrtohen e miratohen edhe në KKTKM. Procedura më pas vijon me urdhër ministri. Mbikëqyrja e punimeve kryhet nga DRTK Gjirokastrë.

Neni 12

Dispozita të fundit

1. Shtesat dhe ndryshimet në këtë plan bëhen me propozim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.

2. Këtij plani i bashkëngjitet zonifikimi i “qendrës historike”, i zonës mbrojtëse të saj dhe tabelat përkatëse të koordinatave gjeografike.



B1	535486.367548362	4457583.03359841
B2	535528.175119342	4457588.16559091
B3	535550.16999502	4457584.87624269
B4	535554.093767586	4457554.66651533

B5	535543.818630668	4457528.39974641
B6	535555.223716531	4457515.49853916
B7	535543.575565056	4457479.663316
B8	535454.085575434	4457461.96897035
B9	535441.079847362	4457463.45011784
B10	535417.713297664	4457507.14044224
B11	535402.347204123	4457507.9936727
B12	535394.965840999	4457519.68018051
B13	535366.378073927	4457517.69540401
B14	535364.274199013	4457512.75032409
B15	535338.500740886	4457515.40561268
B16	535324.983079768	4457535.28404017
B17	535323.442704623	4457551.42387034
B18	535338.482786524	4457569.69292164
B19	535349.728474076	4457590.72028379
B20	535348.735452419	4457600.89451799
B21	535357.43924735	4457609.57193778
B22	535367.862412418	4457604.37712706
B23	535383.434256362	4457610.00226764
B24	535394.262087123	4457619.30659553
B25	535403.257144589	4457616.26429151
B26	535415.936492838	4457633.90552194
B27	535427.041137122	4457634.57456446
B28	535435.991275851	4457641.0940753
B29	535478.419174918	4457614.76668688
B30	535487.472310296	4457599.38670815

Z1	535492.765726996	4457629.6398283
Z2	535570.223330923	4457592.37359668
Z3	535612.282689597	4457544.14517985
Z4	535654.145606501	4457487.58788381
Z5	535650.294064658	4457452.40624515
Z6	535650.95330223	4457412.92760836
Z7	535630.241534428	4457394.63114611
Z8	535576.840736536	4457391.91153236
Z9	535490.913549428	4457420.50122906
Z10	535426.031105573	4457447.03153053
Z11	535393.531451686	4457472.78888382
Z12	535359.155797134	4457495.45307198
Z13	535327.923469417	4457503.01803134
Z14	535304.393535451	4457531.28538162
Z15	535310.121423745	4457569.86857441
Z16	535304.279113885	4457606.238462
Z17	535315.233640678	4457638.98555385
Z18	535378.081638759	4457642.67298682
Z19	535418.923350383	4457652.11816442
Z20	535440.667168177	4457651.91183251
Z21	535460.469601887	4457662.49222973
Z22	535494.04584529	4457658.94871675
Z23	535501.918760811	4457643.2547505